

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të ish-ndërmarrjeve bujqësore”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Zhvillim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm,
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Nuk ka përafrim me legjislacionin e BE-së
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Strategjia Ndërsektorale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.709, datë 29.10.2014 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektorale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020”, të ndryshuar.
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	22-11-2021 deri 21-12-2021
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	10 dhjetor 2021
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2022 – MBZHR- Nr.1
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Entela Kola e-mail-i: entela.kola@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 0688535551 Glaudiana Musaj e-mail-i: glaudiana.musaj@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 0688846379
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe) PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja e qeverisë?</i>	
Gjatë kryerjes së procesit të privatizimit janë evidentuar shumë probleme që lidhen me zbatimin e kritereve të përcaktuara në ligj. Rezultojnë rreth 1100 objekte, për të cilat nuk ka përfunduar procesi i privatizimit dhe mund të jetë një objekt i veçantë apo një pjesë e tij (këto objekte i përkasin ish- Ndërmarrjeve Bujqësore (NB) dhe ndërmarrjeve bujqësore të braktisura). Objektet e mbetura pa përfunduar procesin e privatizimit mund të jenë në fazat kur për një pjesë ka përfunduar procesi i likuidimit (sipas vlerësimit të bërë konform VKM nr.666, datë 26.10.1998, “Për disa masa lidhur me procesin e likuidimit të ndërmarrjeve të varësisë së ish-Agjensisë Qendrore të Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore” si dhe akte	

të dala në zbatim të tij, për disa mund të jetë nënshkruar kontratë shitje, por pa formën e kërkuar nga ligji (të lidhura para noterit) dhe për disa objekte megjithëse janë kryer pagesat nuk është nënshkruar kontrata e shitjes.

Shkaqet që diktojnë këtë ndërhyrje, janë mos nënshkrimi i kontratave të privatizimit para noterit, nga viti 1992, në kundërshtim me legjislacionin për transferimit të pronës së paluajtshme, duke e bërë të pamundur kryerjen e veprimeve pranë ASHK-së.

Përcaktimet e VKM nr.666, datë 26.10.1998 aktualisht nuk janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ligji në bazë të të cilit është miratuar kjo VKM është shfuqizuar. Në këto kushte nuk mund të vijohet me ndryshimin e këtij vendimi dhe lind nevoja për përcaktimin e institucioneve përgjegjëse për përfundimin e procesit të privatizimit të objektve të ish-NB, të institucionit përgjegjës për kryerjen e regjistrimit të kontratës së shitjes dhe pajisjen me dokumentacion pronësie të personave fizikë/juridike. Gjithashtu duhen bërë përmirësime të procedurës së këtij privatizimi.

Këto janë arsytet pse është hartuar ky projektligj në të cilin përcaktohen institucionet për përfundimin e procesit të privatizimit si dhe procedura për përfundimin e këtij procesi.

Ndërhyrja e parashikuar nëpërmjet politikës që propozohet, mundëson zgjidhjen e problemeve të evidentuara gjatë procesit të privatizimit të objekteve të ish-Ndërmarrjeve Bujqësore.

Efektet e pritshme të projektaktit, së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, krijojnë kushtet që personat që kanë privatizuar objekte të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe i posedojnë ato, por nuk janë regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe nuk janë pajisur me dokumenta pronësie, të përfundojnë procesin dhe objektet të regjistrohen dhe pajisen me dokumentacion pronësie.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

- Përfundimi i transferimit të pronësisë nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së shitjes, nga Agjencia Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, në territorin e së cilës ndodhet prona.
- Kryerja e regjistrimit të kontratave të shitjes nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në territorin e së cilës ndodhet prona dhe pajisja me dokumentacion pronësie e personave juridikë, fizikë dhe individë.
- Përcaktimi i procedurave për përfundimin e procesit të privatizimit nëpërmjet miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Për arritjen e objektivave të politikës janë shqyrtuar opsionet e mëposhtme:

- Opsioni 0 (*status quo*). Nuk do të ndërhyhet me një politikë, nuk do të hartohet ligji për rregullimin e këtyre çështjeve. Mos ndërhyrja dhe ruajtja e status quo-së, do të çojë në mos zgjidhjen e probleme të hasura dhe përkeqësim të situatës.
- Opsioni 1: Hartimi i një ligji të ri, për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve

të ish- Ndërmarrjeve Bujqësore është pranuar si opsioni më i përshtatshëm, më i plotësuar dhe më i zbatueshëm, pasi problemet e hasura duhen adresuar me qëllim eliminimin e të gjitha të metave dhe mangësive të vërejtura.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimet ekonomike të opsionit të preferuar (opsioni 1). Kostot e drejtpërdrejta për sektorin publik.

Nga pikëpamja financiare përfitimet për subjektet do të jenë nga mundësia e zhvillimit të pronës, nga mundësia e shfrytëzimit të saj për qëllime biznesi si dhe nga kthimi i objekteve të privatizuara në objekte industriale/tregtare.

Do të ketë gjithashtu edhe *disa lloje ndikimesh jo të drejtpërdrejta ekonomike* që janë pa vlerë monetare të drejtpërdrejta në buxhet dhe konsistojnë në rritjen e përgjegjësisë së subjekteve që do të zhvillojnë aktivitetin e tyre në këto objekte që do privatizohen për të ushtruar një aktivitet formal.

Ndikimi mjedisor i drejtpërdrejtë, ka të bëjë me faktin që shfrytëzimi i këtyre pronave tashmë i plotësuar me dokumentacion legal ndikon në mbrojtjen e mjedisit, pasi përdorimi i këtyre objekteve për qëllime biznesi do të sjellë për rrjedhojë edhe zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Dhënia mundësi subjekteve për shfrytëzimin e këtyre pronave e objekteve për qëllimet për të cilat janë adresuar në fillim të procesit, e bën aktualisht proces me ndikim pozitiv të drejtpërdrejtë edhe në mjedis. Për sa më sipër, zbatimi i këtij ligji do të ketë ndikim pozitiv në mjedis.

Ndikimi Social jo i drejtpërdrejtë. Miratimi e zbatimi i këtij ligji sjell më shumë mundësi në shfrytëzimin e këtyre objekteve të lëna, duke rritur mundësitë për veprimtari ekonomike, duke sjell mundësi për më shumë të punësuar e të vetëpunësuar.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Analiza me shumë kritere e kryer për të tre opsionet tregoi se opsioni 1, Hartimi i një ligji të ri, për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të ish-Ndërmarrjeve Bujqësore, është pranuar si opsioni më i përshtatshëm, më i plotësuar dhe më i zbatueshëm, pasi problemet e hasura duhen adresuar me qëllim eliminimin e të gjitha të metave dhe mangësive të vërejtura.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare, menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë): të rishikohet dhe rivlerësohet!

Viti 1	Viti 2	Viti 3
0	0	0

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?) çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Projektligji “Për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të ish-ndërmarrjeve bujqësore”, së bashku me relacion shpjegues janë shpallur për konsultim publik në Regjistrin Elektronik të Konsultimit Publik në eëbsite <http://www.konsultimipublik.gov.al>, në datë 22 nëntor 2021, (afati i mbylljes së konsultimit, data 21 dhjetor 2021). Deri tani nuk ka pasur komente nga grupet përkatëse. Hartimi i projektligjit është kryer sipas problematikave të dala për sejcilin target grupi të prekur.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi dhe monitorimi do të realizohen sipas përcaktimeve të dispozitave të projektligjit. Autoritetet përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin janë:

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,
- 4 Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB) Tiranë, Lushnje, Korçë dhe Shkodër,
- Ministria e Financës dhe Ekonomisë dhe
- Agjencia Shtetërore e Kadastrës, me Drejtoritë Vendore të saj.

Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor do të nënshkruajnë kontratat e shitjes së objekteve të privatizuara, ndërsa Agjencia Shtetërore e Kadastrës do të kryejë regjistrimin e kontrave të shitjes së objekteve të privatizuar dhe do të pajisë me dokument pronësie pëersonat juridikë, fizikë dhe individë.

Procedurat dhe mënyra e arkëtimit të pagesave të prapambetura, për vlerën e përcaktuar të privatizimit, që do të ndiqen nga institucionet përgjegjëse për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të ish-NB, do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Rezultojnë rreth 1100 objekte, për të cilët nuk ka perfunduar procesi i privatizimit. Këto mund të jenë një objekt i veçantë apo një pjesë e tij që i përkasin ish -NB-ve.

Sa më sipër një numër i kufizuar i objekteve kanë mbetur plotësisht të paprivatizuara, ndërsa një numër i madh objektivash janë pjesërisht të paprivatizuara, deri në 1/6 e tyre. Mund të ketë raste të përsëritura (psh. një stallë mund ta kenë zënë 6 persona, nga të cilët 5 prej tyre kanë likujduar detyrimin, disa mund dhe të jenë pajisur me kontratë shitje dhe të tjerët jo, si dhe njëri person mund të mos ketë bërë pagesën).

Të gjithë personat që kanë zënë objektet janë të evidentuar dhe të shpallur debitor për objektet ndërtimore sipas VKM nr. 403, datë 15.08.1994 “Për arkëtimin e detyrimeve financiare në Ndërmarrjet në varësi të Agjencisë Qëndrore të Ristrukturimit dhe Privatizimit të NB-ve” dhe janë njoftuar në mënyrë të përsëritur që të bëjnë likujdimin konform VKM nr. 666, datë 26.10.1998 “Për disa masa lidhur me procesin e likujdimit të ndërmarrjeve të

varësisë së ish- Agjensisë Qendrore të Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore”, Udhëzimit nr. 1/1, datë 17.12.2002 të tij, pika 4, ku citohet: “Të gjithë debitorët privatë të krijuar sipas VKM nr. 403, datë 15.08.1994 ose për rastet e tjera të konstatuara për periudhën e mëvonshme, detyrimet financiare ti paguajnë 100% në lekë. Vlera e çdo objekti ose pjesë e tij do të llogaritet: vlefë fillestare minus amortizimin kontabël = vlefë e mbetur e cila shumëzohet me koeficientin e indeksit të mallrave të konsumit të muajit paraardhës në të cilin bëhet pagesa, si dhe me koeficientin e indeksit të venndodhjes”.

Zbatimi i këtij vendimi bëri që vlera e objektit të rritej, pasi indeksi i çmimit tashmë ishte rritur rreth 2 herë (nga 4.6 – 9.6), gjë që çoi në pamundësi likuidimi.

Gjithashtu genplanet e përgatitura nga një inxhinjer me licencë duhet të paguheshin nga vetë debitorët dhe kjo tarifë e rriste dhe më shumë vlerën e objektit.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Janë adresuar dhe mbetur pa zgjidhje shumë probleme që lidhen me zbatimin e kriterëve të përcaktuara në legjislacionin për privatizimin.

Rezultojnë rreth 1100 objekte, për të cilat nuk ka përfunduar procesi i privatizimit, ku mund të jetë një objekt i veçantë apo një pjesë e tij (këto objekte i përkasin ish- Ndërmarrjeve Bujqësore NB dhe ndërmarrjeve bujqësore të braktisura).

Objektet e mbetura pa përfunduar procesin e privatizimit mund të jenë në fazat kur për një pjesë ka përfunduar procesi i likuidimit (sipas vlerësimit të bërë konform VKM nr.666, datë 26.10.1998, të Këshillit të Ministrave “Për disa masa lidhur me procesin e likuidimit të ndërmarrjeve të varësisë së ish-Agjensisë Qendrore të Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore” si dhe akte të dala në zbatim të tij, dhe për disa mund të jetë nënshkruar kontratë shitje, por pa formën e kërkuar nga ligji (të lidhura para noterit) apo për disa objekte megjithëse janë kryer pagesat nuk është nënshkruar kontrata e shitjes.

Problematikat e evidentuara për të cilat kërkohet të ndërmerret kjo politikë janë dosjet e privatizimit për të cilat:

- a) Objekte për të cilët ka përfunduar procesi i vlerësimit, likuidimit dhe lidhjes së kontratës së shitjes nga ish-Agjencia Qendrore të Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore-ve sipas Vendimit nr.161, datë 8.4.1993, të Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa e ndryshime në VKM-së nr. 452, datë 17.10.1992” dhe Vendimit nr. 510, datë 26.10.1993, të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin e mjeteve themelore, pasuri shtetërore të ndërmarrjeve bujqësore”, i ndryshuar. Kontratat nuk janë nënshkruar para noterit në formën e kërkuar nga ligji për efekt regjistrimi.

- b) Objekte për të cilët ka përfunduar procesi i vlerësimit dhe lidhjes së kontratës, por me likujdime të pjeshme ose të papaguara të vlerës së kontratës dhe jo të nënshkruara përpara noterit.
- c) Objekte për të cilët ka përfunduar procesi i vlerësimit nga ndërmarrja dhe është kryer likujdimi i plotë, por nuk është pajisur me kontratë shitje nga ish -AQRP të NB-ve.
- d) Objekte për të cilët ka përfunduar procesi i vlerësimit nga ndërmarrja, dhe është kryer likujdimi i pjesshëm, por nuk është pajisur me kontratë shitje nga ish -AQRP të NB-ve.
- e) Objekte për të cilat nga ish-Drejtoria e Ndërmarrjeve të Braktisura është hartuar një akt-dorëzimi i objekteve, dorëzuar personave privatë dhe për të cilat është bërë një vlerësim sipas akteve në fuqi për privatizimin.

Grupet që preken janë:

- Qeveria (Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, së bashku me 4 Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, me Drejtoritë Vendore)
- Subjektet përfituese nga privatizimi.

Përcaktimet e VKM nr.666, datë 26.10.1998 aktualisht nuk janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ligji në bazë të të cilit është miratuar kjo VKM është shfuqizuar. Në këto kushte nuk mund të vijohet me ndryshimin e këtij vendimi dhe lind nevoja për përcaktimin e institucioneve përgjegjëse për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të ish-NB, të institucionit përgjegjës për kryejën e regjistrimit të kontratës së shitjes dhe pajisjen me dokumentacion pronësie të personave fizikë/juridike. Gjithashtu duhen bërë përmirësime të procedurës së këtij privatizimi.

Ndërhyrja e parashikuar nëpërmjet politikës që propozohet, mundëson zgjidhjen e problemeve të evidentuara gjatë procesit të privatizimit të objekteve të ish-Ndërmarrjeve Bujqësore.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Ndërhyrja e parashikuar nëpërmjet politikës që propozohet, mundëson zgjidhjen e problemeve të evidentuara gjatë procesit të privatizimit të objekteve të ish- Ndërmarrjeve Bujqësore.

Qëllimi i hartimit të këtij projektakti është të përcaktojë institucionet të cilat do të përfundojnë procesin e privatizimit të objekteve të ish ndërmarrjeve bujqësore. Privatizimi i objekteve të ish ndërmarrjeve bujqësore është kryer bazuar në Vendimin nr. 666, datë 26.10.1998, të Këshillit të Ministrave “Për disa masa lidhur me procesin e likujdimit të ndërmarrjeve të varësisë së ish-Agjënsisë Qendrore të Ristrukturimit dhe Privatizimit të

Ndërmarrjeve Bujqësore ” si dhe akte të dala në zbatim të tij. Gjatë zbatimit të parashikimeve në këtë vendim lind nevoja për përmirësime dhe sqarime të procedurës së privatizimit. Meqenëse parashikimet e vendimit të cituar nuk janë tashmë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si dhe ligji në bazë të të cilit është miratuar Vendimi nr.666, datë 26.10.1998, i Këshillit të Ministrave është shfuqizuar, nuk mund të vijohet me ndryshimin e tij.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Politika e propozuar synon realizimin e objektivave si më poshtë:

- Përfundimi i transferimit të pronësisë nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së shitjes, nga Agjencia Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, në territorin e së cilës ndodhet prona.
- Kryerja e regjistrimit të kontratave të shitjes nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në territorin e së cilës ndodhet prona, dhe pajisja me dokumentacion pronësie e personave juridikë, fizikë dhe individë.
- Përcaktimi i procedurave për përfundimin e procesit të privatizimit nëpërmjet miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Gjatë analizës së kryer, janë shqyrtuar të tre opsionet:

- Opsioni 0 (*status quo*): Nuk do të ndërhyhet me një politikë, nuk do të hartohet ligji për rregullimin e këtyre çështjeve. Mos ndërhyrja dhe ruajtja e status quo-së, do të çojë në mos zgjidhjen e probleme të hasura dhe përkeqësim të situatës.
- Opsioni 1: Hartimi i një ligji të ri, për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të ish-Ndërmarrjeve Bujqësore. Është pranuar si opsioni më i përshtatshëm, më i plotësuar dhe më i zbatueshëm, pasi problemet e hasura duhen adresuar me qëllim eliminimin e të gjitha të metave dhe mangësive të vërejtura.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku*

- është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
- *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*

Grupet që preken janë:

- Qeveria (Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, së bashku me 4 Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, me Drejtoritë Vendore)
- Subjektet përfituese nga privatizimi.

Ndikimet ekonomike

Përfitimet për buxhetin e shtetit do të jenë vjelja e të ardhurave nga rivlerësimi i pronës, nga shitblerja e truallit. Ka edhe shpenzime për subjektet që do të kryejnë pagesat e nevojshme që nga vlerat e rivlerësimit të objekteve apo pagesat e skicave gentplaneve etj që lidhen me truallin dhe objektet.

Ndikimet mjedisore

Lidhen me shfrytëzimin e këtyre pronave, pasi përdorimi i këtyre objekteve për qëllime biznesi do të sjellë për rrjedhojë edhe zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Dhënia mundësi subjekteve për shfrytëzimin e këtyre pronave e objekteve për qëllimet për të cilat janë adresuar në fillim të procesit, e bën aktualisht proces me ndikim pozitiv të drejtpërdrejtë edhe në mjedis. Për sa më sipër, zbatimi i këtij ligji do të ketë ndikim pozitiv në mjedis.

Ndikimet sociale:

Nuk ka.

Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:

- *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
- *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*

Ndikimet ekonomike

Do të ketë gjithashtu edhe *disa lloje ndikimesh jo të drejtpërdrejta ekonomike*, që janë miratimi e zbatimi i këtij ligji sjell më shumë mundësi në shfrytëzimin e këtyre objekteve të lëna, duke rritur mundësitë për veprimtari ekonomike, duke sjellë mundësi për më shumë të punësuar e të vetëpunësuar.

Ndikimet sociale

Në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, projektligji ka ndikim tek rritja e punësimit. Miratimi e zbatimi i këtij ligji sjell më shumë mundësi në shfrytëzimin e këtyre objekteve të lëna, duke rritur mundësitë për veprimtari ekonomike, duke sjellë mundësi për më shumë të punësuar e të vetëpunësuar

Diskutoni kufizimin e analizës:

- *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
- *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
- *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*

Rritja dhe fuqizimi i bujqësisë në vend, ndikohet edhe nga fakti që këto prona trual bujqësor apo edhe objekte, kërkojnë një riorganizim, për tu vënë në funksion të veprimtarive të biznesit nga subjektet përfitues dhe për të angazhuar më shumë burimeve njerëzore në funksion. Gjithashtu projektligji do të mundësojë një ndarje të mirë të detyrave dhe përgjegjësi midis Agjencive dhe Institucioneve shtetërore buxhetore të vëna në funksion të zbatimit.

Risk i identifikuar, është “Mangësitë në dosjet e privatizimit”, të cilat përcaktojnë grupe që nuk përfitojnë nga procesi.

- *Përmbliidni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*
- *Vlerësimi i opsioneve:*

Vlerësimi i opsionit nga grupi i punës për hartimin e projektligjit “Hartimi i një ligji të ri, për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të ish-Ndërmarrjeve Bujqësore, është pranuar si opsioni më i përshtatshëm, më i plotësuar dhe më i zbatueshëm, pasi problemet e hasura duhen adresuar me qëllim eliminimin e të gjitha të metave dhe mangësive të vërejtura. Opsioni 0 (*status quo*): Nuk do të ndërhyjmë me ndryshim apo politikë të re, ky opion nuk zgjidh problemet e hasura dhe për më tepër mund të çojë në përkeqësim të situatës.

Në përfundim të krahasimit dhe analizës së kryer u arrit në konkluzionin që paraqitja e projektligjit të ri, për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të ish-Ndërmarrjeve Bujqësore është pranuar si opsioni më i përshtatshëm, më i plotësuar dhe më i zbatueshëm dhe që mundëson zgjidhjen e problemit.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i preferuar është Opsioni 1. Hartimi i një ligji të ri, për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të ish-Ndërmarrjeve Bujqësore që është pranuar si opsioni më i përshtatshëm, më i plotësuar dhe më i zbatueshëm, pasi problemet e hasura duhen adresuar me qëllim eliminimin e të gjitha të metave dhe mangësive të vërejtura.

Opsionet që merren në konsideratë janë:

- Opsioni 0 (*status quo*): Nuk do të ndërhyjmë me ndryshim apo politikë të re.
- Opsioni 1: Hartimi i një ligji të ri, për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të ish- Ndërmarrjeve Bujqësore që është pranuar si opsioni më i përshtatshëm, më i plotësuar dhe më i zbatueshëm, pasi problemet e hasura duhen adresuar me qëllim eliminimin e të gjitha të metave dhe mangësive të vërejtura. Për të vlerësuar opsionet duke përdorur analizën me shumë kritere, janë ndjekur hapat e mëposhtëm:

1. Përcaktimi i kritereve që tregojnë arritjen e objektivit. Përcaktimi i institucionet të cilat do të përfundojnë procesin e privatizimit të objekteve të ish-ndërmarrjeve bujqësore.

- Efektiviteti në realizimin 100% të transferimit të pronësisë, nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së shitjes nga Agjencia Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, në territorin e së cilës ndodhet prona.
- Efektiviteti i regjistrimit të kontratave të shitjes nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në territorin e së cilës ndodhet prona.
- Efektiviteti në përcaktimin e procedurave për përfundimin e procesit të transferimit të pronësisë.
- Shkalla e riskut si rrjedhojë e mospërfundimit të procesit të privatizimit të objekteve të ish ndërmarrjeve bujqësore.
- Kostot

2. Vendosja e peshës së kritereve sipas rëndësisë relative

- Efektiviteti në realizimin 100% të transferimit të pronësisë, nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së shitjes nga Agjencia Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, në territorin e së cilës ndodhet prona: 4.
- Efektiviteti i regjistrimit të kontratave të shitjes nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në territorin e së cilës ndodhet prona: 3.
- Efektiviteti në përcaktimin e procedurave për përfundimin e procesit të transferimit të pronësisë: 5.
- Shkalla e riskut si rrjedhojë e mos përfundimit të procesit të privatizimit të objekteve të ish-ndërmarrjeve bujqësore: 4.
- Kostot: 3.

3. Përcaktimi i shkallës së performancës nëpërmjet intervalit të pikëve nga 0 – 5.

4. Vendosja e pikëve të opsioneve përkundrejt secilit kriter sipas matricës së mëposhtme.

Matrica e performancës:

Kriteret	Pesha (Rëndësia relative)	Opsioni 0		Opsioni 1	
		Pikë	Vlera (= Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)
Efektiviteti në realizimin 100% të transferimit të pronësisë, nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së shitjes nga Agjencia Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, në territorin e së cilës ndodhet prona	4	0	0	5	20
Efektiviteti i regjistrimit të kontratave të shitjes nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në territorin e së cilës ndodhet prona	5	1	5	4	20
Efektiviteti në përcaktimin e procedurave për përfundimin e procesit të transferimit të pronësisë	3	2	6	5	15
Shkalla e riskut si rrjedhojë e mos përfundimit të procesit të privatizimit të objekteve të ish-ndërmarrjeve bujqësore	4	5	20	2	8
Kosto	2	2	4	5	10
Pikët totale për secilin opcion		<u>35</u>		<u>73</u>	

Analiza me shumë kriteret tregon se opsioni 1 (Hartimi i një ligji të ri, për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të ish-Ndërmarrjeve Bujqësore.) është vlerësuar me më shumë pikë dhe ne e kemi zgjedhur atë si opcionin tonë të preferuar.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, së bashku me 4 Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë dhe Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, me Drejtoritë Vendore janë institucionet përgjegjëse për monitorimin e zbatueshmërisë së tij, pas miratimit të këtij propozimi.

Gjatë zbatimit të projektligjit të propozuar, për të arritur qëllimet e politikës, do të

ndërmerren masat e mëposhtme:

- Ndërgjegjësimi i subjekteve përfituese nga privatizimi për kryerjen e pagesave të privatizimit të objekteve të ish-NB-ve.
- Realizimi i procesit përmbyllës të privatizimit të objekteve të ish-NB-ve.
- Ndjekja në mënyrë korrekte e procedurave të privatizimit që do të përcaktohen në Vendimin e Këshillit të Ministrave.
- Monitorimi i përfundimit të procesit të privatizimit të objekteve të ish-NB-ve, nga AREB-et, MBZHR dhe ASHK.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmblëdhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Propozimi i këtij projektligji përmban elementë të rëndësishëm, për zbatimin e planit të punës, dhe një element i rëndësishëm për zbatimin e këtij plani është sistemi i monitorimit dhe vlerësimit në zbatimin e ligjit, bazuar në problemet e konstatuara.

Indikatorët për të matur arritjen e objektivave janë si më poshtë:

- Shkalla e ndërgjegjësimi të subjekteve për kryerjen e pagesave të privatizimit të objekteve të ish-NB-ve.
- Realizimi 100% i procesit përmbyllës të privatizimit të objekteve të ish-NB-ve.
- Ndjekja periodike, nga AREB-et, MBZHR dhe ASHK, e procedurave të privatizimit, në raport me totalin e objekteve në proces.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										

Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e koston në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e koston në total										

Raporti i ndikimit të vlerësimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			

MINISTËR

Frida Krifca